



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 32
Prishtinë, më 20 Nëntor 2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-225

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Driton Selmanaj, Verica Qeraniq, Mërgim Lushtaku, Valon Ramadani, Avdullah Hoti, Andin Hoti, Etem Arifi, Emilija Redžepi, dhe Ali Lajçi.

Munguan: Albert Kinolli dhe Faton Topalli.

Stafi mbështetës: Mehmet Simnica, Ajet Avdullahu dhe Endrit Rustemi.

I ftuar: Sadik Kryeziu, kryesues i Bordit të NP "Trainkos" Sh.A.
Durim Krasniqi, Zyrtar Kryesor Financiar – NP "Trainkos" Sh.A.

Pjesëmarrësit tjerë: Vjoleta Smajlaj, Vlora Spanca dhe Ever Boqolli nga ZKA-ja, Erëblina Ajazi nga Kuvendi i Kosovës, Besjana Bajrami nga EO, Gentiana Kadrija nga Kosova Press dhe Egzon Murturi nga KDI dhe Dorontina Kastrati nga BIRN.

Mbledhjen e kryesoi: Driton Selmanaj, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me datë 06.11.2018;**
- 3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Ndërmarrjes Publike Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.a, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017;**
- 4. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve nga raporti i auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 06.11.2018

Procesverbali i mbledhjes, të mbajtur më 06.11.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Ndërmarrjes Publike Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.a, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017

Emilija Redžepi tha se raportet e dhëna nga ndërmarrja nuk janë të sakta dhe nuk janë sipas standardeve të auditimit, mirëpo theksoi se nëse e krahasojmë me vitin e kaluar, kjo ndërmarrje ka pasur përmirësim në menaxhim.

Ajo tha që llogaritë e arkëtueshme gjatë vitit 2017 ishin zvogëluar për 523,232€ të cilat ishin borgje të vjetra të pa arkëtuara të cilat ndërmarrja i kishte shpallur si borgj i keq. Për këtë shumë ishte zvogëluar kapitali rezervë. Ajo gjithashtu përmendi edhe rivlerësimin e pasurive jo qarkulluese të cilin ndërmarrja nuk e kishte bërë, si dhe tha që kapitali rezervë në fund të vitit 2016 kishte një saldo prej rreth 5min.€. Lidhur me rekomandimet ajo tha që ndërmarrja ka një përmirësim, mirëpo që ka ende shumë punë për të bërë.

Në fund ajo shtoi se megjithëse shihet një përparim, Trainkos-i duhet ta hartoj një raport financiar sipas standardeve të kërkuara që megjithatë ende nuk e kemi.

Sadik Kryeziu, përfaqësues i ndërmarrjes, me këtë rast tha se Trainkos është ndër ndërmarrjet e para publike që ZKA ka bërë auditimin e pasqyrave vjetore financiare. Ai tha se i gjithë stafi është mobilizuar dhe ka arritur t'i përmbush 74 për qind të rekomandimeve, gjë të cilën ai e konsideroi arritje, krahasuar me gjendjen e rëndë që ka pasur kjo ndërmarrje ndër vite.

Sa i përket planeve dhe strategjisë që ka kjo ndërmarrje, ai tha se si bord drejtues nuk mund të bëjë plane afatgjata, për shkak të borxheve të cilat ekzistojnë që nga viti 2002 dhe se po kërkojnë mbështetje nga institucione përkatëse që të paktën mos të kontraktohen kompani private për transport të mallrave, ngase, sipas tij, kjo e dëmton këtë ndërmarrje edhe më shumë. Ai gjithashtu tha që Qeveria e Kosovës nuk ka investuar në Treinkos. Qeveria ka dhënë investime vetëm 1mil.€.

Durim Krasniqi, zyrtar kryesor financiar i ndërmarrjes, tha që kanë qenë të detyruar që ti fshijnë borgjet e këqija të cilat ekzistonin që nga viti 2002 e deri në vitin 2011 dhe të cilat ishin të pamundur të inkasohen. Për të mos dhënë një pasqyrë të rrejshme, Bordi ka vendosur të i fshij këto borgje nga pasqyrat financiare.

Avdullah Hoti tha që trajtimi i borgjeve nga ndërmarrja duke e zvogëluar kapitalin rezervë dhe mospërputhjet në mes numërimit të stoqeve dhe shënimeve kontabël të stoqeve, i bënë të gjitha shifrat financiare të ndërmarrjes jokredibile. Ai tha që ndërmarrja ka zvogëluar kapitalin për të barazuar

llogaritë. Ai gjithashtu shprehi shqetësimin për punësimet pa konkurs. Edhe në rastet kur janë bërë konkurset, ai tha që nuk janë respektuar fare procedurat.

Emilija Redžepi pyeti rreth obligimeve të papaguara që ka ndërmarrja si dhe sa është mbështetja e Qeverisë për zhvillimin e hekurudhave. Ajo gjithashtu pyeti se sa Treinkos-i po i shfrytëzon fondet evropiane për këtë qëllim. Znj.Redzepi shtoi se Qeveria nuk është duke bërë sa duhet për ndërmarrjen publike në përgjithësi dhe propozoi që Komisioni të bëjë një rekomandim Qeverisë që të këtë me shumë vëmendje tek ndërmarrjet publike.

Sadik Kryeziu tha që Autoriteti rregullativ ka licencuar edhe një kompani private në transportin e mallrave duke na bërë konkurrencë, kurse ndërmarrja bazën kryesore e ka në transportin e mallrave. Ai tha që tani jemi rreth 230 punëtorë dhe numri i punëtorëve ka shkuar duke u zvogëluar.

Avdullah Hoti tha që investimi që është duke ndodhur në Infrakos, do të ndikoj në të hyra të ndërmarrjes Trainkos dhe praktikisht do të nxjerrë jashtë funksionimit për një kohë deri sa të riparohet traseja e hekurudhës. Mirëpo kjo nuk e arsyeton mungesën e vendosmërisë e menaxhmentit që të menaxhoj si duhet me financat dhe kompania duhet të ketë sensin e funksionimit të biznesit sepse tashmë tregu pothuajse është liberalizuar dhe është normale që të ketë operator privat në ofrimin e shërbimeve. Ai tha që kompania duhet ta mbaj vetveten kurse për investime kapitale duhet të përkujdeset Qeveria.

Ali Lajçi tha që nuk ka një strategji zhvillimore të hekurudhave në Kosovë. Ai tha që të gjitha Qeveritë e pas luftës por edhe menaxhmenti i ndërmarrjes kanë përgjegjësi për këtë gjendje të krijuar në Trainkos.

Driton Selmanaj tha që KMFP nuk ka pasur ndonjë raport paraprak për të shikuar se si ka evoluar puna e menaxhmentit të ri. Ai tha që ky raport të jetë si bazë që në vitet e ardhshme edhe nëse pasqyrat financiare janë negative, së paku të jenë të sakta, sepse nëse pasqyrat financiare nuk janë të sakta, atëherë për gjithçka lind dyshimi.

Përfundim

KMFP-ja vendosi që Raporti i Auditimit për Ndërmarrjes Publike Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.a për vitin 2017, të mos adresohet më seancë plenare, mirëpo, Kompania duhet të përgatisë planin e veprimit dhe ta dërgojë në KMFP.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve nga raporti i auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017

Avdullah Hoti tha që për pikën “j” të rekomandimeve ku shkruan që “Ministri duhet të siguroj që të gjitha marrëveshjet e mirëkuptimit/bashkëpunimit të nënshkruhen nga ai ose ta autorizoj Sekretarin...”, nuk duhet të jetë kështu sepse Ministri nuk mund ta autorizoj Sekretarin. Mundet ta autorizoj njërin nga zv.ministrat por jo Sekretarin.

Përfundim

KMFP vendosi që Raportit Vjetor i Auditimit për MKRS-së për vitin 2017 të adresohet për Seancë Plenare, së bashku me rekomandimet e KMFP-së.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i komisionit,

Driton Selmanaj